



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E VUSHTRRIË



PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET  
2023 - 2025  
KOMUNA E VUSHTRRISE

\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/2023

## Përmbajtje

Deklarata e Integritetit.....	3
Hyrja.....	4
PLANI PËR INTEGRITET.....	4
Parimet e menaxhimit të Integritetit.....	6
Lidershipi.....	6
Përfshirja e personelit.....	6
Qasja sistemore.....	6
Objektivat e Planit të Integritetit.....	6
Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit.....	7
Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit.....	7
Metodologjia e vlerësimit të rrezikut.....	8
Matrica e vlerësimit të rrezikut.....	8
Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut.....	9
Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi.....	9
Fushat e rrezikut.....	11
Fushat e përgjithshme të Rrezikut.....	11
Fushat specifike të rrezikut.....	11

## Deklarata e Integritetit

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një deklaratë gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikën, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregulluese.

Ky Plan i Integritetit synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modernizuar, të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik lokal, me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efektive dhe cilësore për të gjithë.

Përmes Planit të Integritetit, do të promovohet demokracia lokale në mënyrë që komuna të përmbushë objektivat e saj për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike.

Plani i Integritetit është gjithashtu i harmonizuar me obligimet strategjike, të përcaktuara nga Strategjia e Kosovës Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2021-2023, në të cilat parashihet roli kyç i komunave në zhvillimin dhe implementimin e kornizës së integritetit.

Profesionalizmi, efikasiteti, efektshmëria, kultura organizative, llogaridhënia dhe transparenca në raport me qytetarët do të ndikojnë që të kthejmë integritetin dhe etikën në shtylla kyçe të sistemit tonë të menaxhimit.

Zotohemi që Komuna e Vushtrisë me gjithë sinjoritetin dhe përkushtimin duhet të zhvillojmë më tej kapacitetet e Komunës dhe personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Me plan të integritetit, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standarde, parimet dhe objektiva në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe joprofessionale. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsion në punën e organeve të administratës komunale. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve.

Ne e kuptojmë se, që të jemi të suksesshëm, menaxhimi i rrezikut të integritetit nuk duhet të jetë një ushtrim i vetëm, por të jetë një proces i vazhdueshëm që përkrah zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit. Andaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të integruar menaxhimin e rrezikut ndaj integritetit në kulturën organizative të Komunës në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë.

Integriteti është zgjedhja, si individë, si organizatë dhe si institucion publik, që përfaqësojmë interesat e qytetarëve, që vazhdimisht t'i përmbahemi etikës dhe standardeve profesionale dhe të veprimit sipas parimeve demokratike, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Andaj, ne besojmë që ky plan i integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën kundër korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe respektimit të kodit etik, në mënyrë që qytetarëve t'u kthehet besimi në punën e Komunës së Vushtrisë dhe shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës.

Ferit Idrizi – Kryetar i Komunës

## Hyrja

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe “Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Vushtrrisë ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2023 -2025.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të Komunës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së Komunës dhe ekspozimin e tyre ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

Plani rithekson përkushtimin e Komunës së Vushtrrisë për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah qytetari. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

## PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, plani ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

### **Plani i integritetit mundëson:**

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një Komunë;
- Vlerësimin e çfarëdoj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një Komunë; dhe
- Përcaktimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit dhe sjelljeve tjera jo - profesionale.

### **Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:**

- Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saj organizative, duke vënë përpara një menaxhim proaktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësoj rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëloj mundësitë për korrupsion;
- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë Komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korrupsionit, që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;

- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsionit përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e besimit të punonjësve komunalë dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga Komuna.

Me zbatimin e këtij plani, Komuna do të vendoset më mirë për të siguruar një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara, përfshirë shërbime publike të përmirësuara të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Gjithashtu, Komuna do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të mira për qytetarët dhe rritje të kënaqshmërisë nga ana e qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikrat dhe përfshirjen e punonjësve.

Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të rrezikut që Komuna e Vushtrisë e ka bërë në periudhën 2023 - 2025. Procesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Komunës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh (1) dëmet materiale dhe jo - materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje të ndodhin prapë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikrat relevante dhe nga përfshirja e stafit.

## Parimet e menaxhimit të Integritetit

### Lidershipi

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe Kodit të Etikës. Shumë e rëndësishme është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjithë stafi dhe palët interesit.

### Përfshirja e personelit

Pjesëmarrja e gjithë stafit është shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes, duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i brendshëm dhe i jashtëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore, në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

### Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kjo kërkon nga Komunitat që t'iu kushtojnë vëmendje të gjitha njësive dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre. Një gjë e tillë arrihet brendapërbrenda grupit punues në Komunë.

## Objektivat e Planit të Integritetit

Objekti kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe rendit përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në Komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës, ku të gjithë individët dhe njësitë në Komunë, si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.
- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve mbi rreziqet e korrupsionit dhe të sensibilizojë qytetarët dhe bizneset për rolin e tyre në parandalimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- Përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në Komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve komunale.
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

## Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe/ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të Komunës. I gjithë stafi komunal ka mundësi të marrë pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të Komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

### Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- **Faza përgatitore** – Kryetari i Komunës themelon grupin e punues; përcakton strukturën e grupit punues dhe kryesuesin e tij, mund të delegojë një zyrtar për ta udhëhequr grupin; Kryetari emëron koordinatoren për zhvillimin e planit të integritetit; Grupi punues bënë mbledhjen e informacionit të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe njoftimi i të gjithë stafit për rëndësinë e Planit të Integritetit.
- **Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit** – gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së Komunës; përshkrimet e vendit të punës dhe fushëveprimin e çdo njësie komunale) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale përcakton fushat e rrezikut dhe bënë identifikimi dhe vlerësimin e rreziqeve.
- **Faza e përcaktimit të prioriteteve dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit** – kjo fazë përfshin përcaktimin e prioriteteve për intervenimin, përcaktimi i masave për parandalimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësitë për zbatim.
- **Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit** - përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa, raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirëson zbatimin e objektivave të Planit të Integritetit.

## Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e Komunës dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të Komunës. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues duhet të përcaktojë nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuara dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

### Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, aktivitet të Komunës për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke përshkruar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën, aktivitetin e Komunës në rrugë të mbarë.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

<b>Pasojë /Ndikimi</b>	<b>Madhor</b>	10																		
		9																		
		8																		
	<b>Mesatar</b>	7																		
		6																		
		5																		
		4																		
	<b>Vogël</b>	3																		
		2																		
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10									
<b>Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)</b>		<b>Ulët</b>			<b>Mesatar</b>				<b>Lartë</b>											
		<b>Probabiliteti/Gjasat</b>																		


Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x gjasat (1-10)", treguar në figurën si më lartë.





## Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

 Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

## Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rrezikut të integritetit kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit, raporti duhet të dërgohet për diskutim në Kuvendin Komunal.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. **Grupi punues** - emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës dhe është përgjegjës për:

- promovimin e integritetit në Komunë dhe merr masa për të parandaluar korrupsionin, konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike;
- hartimin e draftit të Planit Komunal të Integritetit;
- përgatitjen e programit për hartimin e planit të integritetit;
- siguron që Plani i Integritetit të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;
- zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar ndaj rreziqeve;
- propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;

Grupi punues mbaron mandatin pas hartimit të planit komunal për integritet. Kryetari i Komunës themelon grupin e ri punues varësisht nga vlerësimi i nevojave.

2. **Koordinatori për integritet** - emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës dhe është përgjegjës për:

- përgatitur metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit;
- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të Komunës, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit;
- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- përgatitë dhe shpërndan pyetësorin si dhe zhvillon intervistat me stafin komunal, me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit;
- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit;

- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planit të Integritetit;
- harton raporte periodike për monitorimin e planit të integritetit dhe i raporton kryetarit.

Koordinatori, gjithashtu, mbështet grupin punues në hartimin dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit. Koordinatori i rekomandon Kryetarit për takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme.

## Fushat e rrezikut

### Fushat e përgjithshme të Rrezikut

1. Udhëheqja dhe menaxhimi;
2. Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
3. Planifikimi dhe Menaxhimi i Buxhetit dhe Financave;
4. Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve;
5. Plani Komunal për Pjesëmarrje Qytetare

### Fushat specifike të rrezikut<sup>1</sup>

1. Auditimi i Brendshëm;
2. Prokurimi publik;
3. Menaxhimi i kontratave publike;
4. Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësia;
5. Planifikimi urban dhe rural;
6. Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
7. Inspektimet;
8. Arsimi Publik;
9. Shëndeti publik;
10. Menaxhimi i pronës së paluajtshme komunale;
11. Parandalimi i konfliktit të interesit për zyrtarët komunal;
12. Subvencionet komunale.

---

<sup>1</sup> Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Komunave.

## FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT

Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut				Veprimi ndaj rrezikut		
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rreziku	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	<b>UDHËHEQJA DHE MENAXHIMI</b>	Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente	Ligjet dhe aktet nënligjore; Raportet periodike; aktet e brendshme të komunës, Plani i Integritetit	6	9	54	Hartimi i Planit Zhvillimor. (Ligji për Planifikim Hapësinor)	Kuvendi dhe Kryetari i Komunës, drejtoritë komunale dhe njësitë përgjegjëse	Qershor 2023 – Qershor 2024
		Mospërfshirja e të gjitha fushave përkatëse në Planin Zhvillimor.				Përfshirja e të gjithë akterëve (komuniteti i biznesit, fokus grupeve, shoqëria civile dhe qytetarët) në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës			
		Opinion publik me perceptcion negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës		4	8	32	Plani i konsultimeve publike në hartimin e Planit Zhvillimor	Kuvendi dhe Kryetari i Komunës, drejtoritë komunale dhe njësitë përgjegjëse	Në vazhdimësi
						Informimi dhe komunikimi me qytetarët përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit (Ueb faqja e komunës, rrjetet sociale,	Kryetari i Komunës, Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtorët e drejtorive	Në vazhdimësi	

		komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës të pamjaftueshme				takimet e drejtpërdrejta me qytetarët)			
						Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin dhe konsultimin e politikave publike në procesin e vendimmarrjes.	Kryetari i komunës, Drejtorët e drejtorive	Në vazhdimësi	
		Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive në administratën komunale		5	8	40	Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.	Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, Drejtorët e drejtorive, udhëheqësit e sektorëve	Dhjetor 2023
		Mos monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit		3	9	27	Hartimi i planit të monitorimit dhe zbatimit të planit të integritetit	Kuvendi i komunës, Kryetari i komunës, Agjencia kundër korrupsionit	Një herë në vit dhe sipas nevojave/kërkesave
							Të rishikohet niveli i zbatimit dhe përditësohen masat për përmirësime.	Menaxheri i integritetit, Koordinator i dhe Grupi Punues i integritetit .	Çdo gjashtë muaj
2.	<b>POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARVE</b>	Mosplotësi i vendeve të punës me staf adekuatë dhe të mjaftueshëm	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	5	8	40	Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit	Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive	Dhjetor të çdo viti
		Mungesa e kapaciteteve profesionale të të punësuarit.		5	8	40	Hartimi i planit të vlerësimit vjetor të zyrtareve komunal.	Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive	Në vazhdimësi

					Analizimi i nevojave për trajnime	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive		
					Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve në të gjitha drejtoritë/njësitë			
					Hartimi i një analize për ndikimin e trajnimeve			
		Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate.	4	7	28	Të bëhet rishikimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve.	Në vazhdimësi
					Harmonizimi i përshkrimit të vendeve të punës.	Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive	Në vazhdimësi	
		Mungesa e kodit komunal të etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit.	7	10	70	Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit	Kryetari i komunës dhe Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve	Në vazhdimësi
		Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës	4	7	28	Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit.	Kryetari i komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve	Në vazhdimësi

		Niveli i pamjaftueshëm i ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteve të tjera të paligjshme brenda institucionit.		5	8	40	Mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteve të tjera të paligjshme.	Kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive, koordinatori i planit të integritetit dhe sinjalizuesi	Në vazhdimësi
3.	<b>PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE</b>	Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal.	Ligjet, aktet nënligjore; KAB, dhe aktet e brendshme të komunës	6	7	42	Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	TM2 – TM3 i vitit fiskal
						Përfshirja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit;	Kuvendi/KPF, Kryetari i komunës; zyrtari kryesor financiar	TM2 – TM3 i vitit fiskal	
		Mosmiratimi me kohë i buxhetit		5	10	50	Planifikimi dhe aprovimi i buxhetit sipas KAB-it dhe Qarkoreve buxhetore	Kuvendi/KPF, Kryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive	30 shtator i çdo viti
		Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent		7	8	56	Planifikimi i saktë i shpenzimeve	Njësitë buxhetore	Pas aprovimit të buxhetit vjetor
Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore.					Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF	Në vazhdimësi Çdo tremujor			
Publikimi i shpenzimeve në ueb faqen e komunës					Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF  Zyra për Komunikim me Publikun				

						Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF	Në vazhdimësi	
		Mos regjistrimi ne E-pasuri		5	10	50	Funksionalizimi i depos /depoist	Drejtoria e Administrates, Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Gjashtëmuor
		Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i pasurisë jo financiare		6	9	54	Përditsimi i regjistrit i brendshëm i aseteve të komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Në vazhdimësi
4.	<b>RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTEVE</b>	Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës.	4	9	36	Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative	Kryetari i komunës, Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK-ut	TM1 2024
							Informimi itë gjithë të punësuarit lidhur me rreziqet nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara	Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK-ut	Në vazhdimësi
		Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit		3	8	24	Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar	Kryetari i komunës, Drejtoria e Administratës	Tremujori i katërt 2023 2023



5.	<b>PLANI KOMUNAL PËR PJESËMARRJE QYTETARE</b>	Moszbatimi i planit komunal	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet tjera, duke përfshirë Planin komunal për pjesëmarrje qytetare	5	8	40	Transparenca e punës së kuvendit komunal	Kryesuesi/sja e kuvendit, sekretaria e kuvendit, Zyra për Komunikim me Publikun	Në vazhdimësi
		Mosmbajtja e konsultimeve publike					Plani vjetor i konsultimeve publike	Kryetari i komunës, Drejtoritë, Zyra për Komunikim me Publikun	TM1 i çdo viti
		Moszgjedhja dhe mosfunksionimi i këshillave lokale					Zgjedhja e këshillave lokale, funksionimi i tyre dhe plani vjetor i bashkëpunimit me komunën	Kuvendi, i komunës, Kryetari i komunës, Drejtoria e Administratës	Në vazhdimësi
		Mosthemelimi i komiteteve konsultative					Themelimi i komiteteve konsultative në harmoni me nevojat e komunës	Kuvendi i komunës, Kryetari i komunës	Për çdo mandat dhe sipas nevojave

FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT									
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut				Veprimi ndaj rrezikut		
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rreziku	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	<b>AUDITIMI I BRENDSHËM</b>	Mungesa e planifikimit vjetor të auditimit.	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	4	8	32	Para se të hartohet Plani Vjetor të bëhet rivlerësim i rrezikut. Të bëhet auditimi sipas Planit Vjetor	Njësia e auditimit, Komiteti i auditimit.	Në fillim të çdo viti
		Mungesa e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit		4	9	36	Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit		
								Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit	ZKF

		Mungesa e koordinimit ndërmjet Njesisë së Auditimit, Komitetit dhe Kryetarit		5	8	40	Të rritet koordinimi dhe komunikimi në mes të njësisë së auditimit dhe njësive sektoriale.	Kryetari i komunës, Njësia e AB, Komiteti i Auditimit dhe njësitë sektoriale	Në vazhdimësi
2.	<b>PROKURIMI PUBLIK</b>	Mungesa e planifikimit vjetor të prokurimit publik	Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës	5	10	50	Ngritja e kapaciteteve për hartimin e planit vjetor të prokurimit publik dhe zbatimin e tij.	Njësia e prokurimit, Drejtoritë dhe njësitë sektoriale	Çdo vit
							Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për zyrtarët që ndërlidhen me prokurimin publik	Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
		Mungesa e transparencës gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik		5	8	40	Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e komunës	Njësia e prokurimit	Pas miratimit të planit të prokurimit
3.	<b>MENAXHIMI I KONTRATAVE PUBLIKE</b>	Mungesa e projekteve zbatuese për menaxhimin e kontratave	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	4	6	24	Përgatitja e projekteve me kompetencë profesionale	Drejtoritë dhe njësitë sektoriale	Në vazhdimësi
							Trajnimi i zyrtarëve për menaxhimin e kontratave		Në vazhdimësi
4.	<b>ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE BUJQËSIA</b>	Mungesa e dokumenteve strategjike për zhvillimin ekonomik lokal		4	9	36	Hartimi, miratimi dhe rishikimi i dokumenteve strategjike për zhvillimin ekonomik të komunës	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Në vazhdimësi

		Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo transparente.		5	7	35	Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës	Kryetari i komunës, Drejtoritë	TM2/TM3
						Të sigurohet pjesëmarrja e të gjithë akterëve relevant gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal.			
		Kritere jo të qarta dhe transparencë të pa mjaftueshme në ndarjen e subvencioneve për zhvillim e bujqësisë dhe sektorëve tjerë				Ndarja e subvencioneve të bëhet sipas Rregullores komunale	Kryetari i komunës (komisionet), Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	Gjatë vitit	
						Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve	Kryetari i komunës; Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	Në vazhdimësi	
<b>5.</b>	<b>PLANIFIKIMI URBAN DHE RURAL</b>	Mos hartimi i dokumenteve të planifikimit që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës.	8	9	72	Të fillohet me hartimin e dokumenteve të planifikimit në mënyrë që të kemi të përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive	Kuvendi Komunal Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	Tremujori i parë 2024

		Mos hartimi i raportit monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave të deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal nga të gjitha Drejtorit sektoriale të Komunës.		5	9	45	Raportimi i rregullt në baza vjetore për zbatimin e të gjitha objektivave të deklaruara ne PZHK.	Drejtoria për Urbanizëm dhe të gjitha drejtorit tjera sektoriale të Komunës	Në baza vjetore
		Numri i vogël i stafit profesional për mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban dhe rural		6	8	48	Të shtohet numri i stafit profesional për planifikim urban dhe rural Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit.		
		Mos zbatimi i afateve ligjore bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor për hartimin e dokumenteve të planifikimit.		8	9	72	Zbatimin e afatit ligjor bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174	Kryetari i komunës, Drejtoria për urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	
6.	<b>STANDARDET E NDËRTIMIT DHE KONTROLLI</b>	Mungesa e kontrolleve konsistente mbi ndërtimet (vend punishtet)	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës dhe planet rregullative urbane	7	9	63	Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje.	Kryetari i komunës, Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit	Në vazhdimësi
		Mungesë e stafit adekuat për kontrollimin e		3	10	30	Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural	Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit	Tremujori i dytë 2024

		ndërtimeve				Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural	Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi	
7.	<b>INSPEKTIMET</b>	Mungesa e Planit vjetor të inspektimeve	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	3	5	15	Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut.	Drejtoria e inspektimeve	Në vazhdimësi
		Mungesa e kapaciteteve profesionale të inspektorëve		5	8	40	Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektorët	Drejtoria e inspektimeve, Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
		Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve		5	8	40	Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja	Kryetari i komunës, Drejtoria e inspektimeve, Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
8.	<b>ARSIMI PUBLIK</b>	Planifikimi i shërbimeve arsimore jo adekuat dhe i paefektshëm	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	5	8	40	Të sigurohet planifikim të shërbimeve arsimore bazuar në nevojat dhe dinamikën e rritjes/zvogëlimin të numrit të nxënësve.	Kryetari i komunës dhe Drejtoria e arsimit	TM2/TM3
		Inspektimet e pamjaftueshme të procesit mësimor		5	10	50	Të hartohet, zbatohet dhe mbikëqyret plani i inspektimeve	Kryetari i komunës dhe Drejtoria e arsimit	Në vazhdimësi
9.	<b>SHËNDETI PUBLIK</b>	Mangësi në rregullativen e brendshme lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe zbatimin jo i plotë i saj	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës si dhe planet	3	5	15	Të rishikohet rregullativa e brendshme me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit.	Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për shëndetësi	Në vazhdimësi
							Të shtohet kontrolli i zbatimit të rregullatives.	Drejtoria për shëndetësi dhe drejtuesit e	Në vazhdimësi

			dhe strategjitë në shëndetësi					institucioneve shëndetësore	
	Funksionimi jo efikas i Sistemit të informacionit shëndetësor.			3	8	24	Funksionalizimi i Sistemit të informacionit Shëndetësor / Përmirësimi i shërbimeve ndaj pacientëve	Drejtoria për shëndetësi dhe drejtuesit e institucioneve shëndetësore	Në vazhdimësi
							Të krijohen aplikacione elektronike për shërbimet publike që mund të ofrohen në mënyre elektronike .	Drejtoria për administratë dhe njësia e TIK-ut	
							Të zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palëve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendim(vendimi të merret nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet në zyrat pritëse nga zyrtari tjetër	Mbikëqyrësi i shërbimeve publike	Në vazhdimësi
							Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbim të përvojave, punëtorive	Drejtoria përkatëse për shërbime publike dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	
	Mangësi në rregullativen e brendshme lidhur me licencimin e shërbimeve			4	9	36	Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e licencimit dhe parandalojnë vendimet subjektive	Kryetari i Komunës dhe Drejtoria përkatëse për licencimin e shërbimeve	Në vazhdimësi

		Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për licencimin e shërbimeve		3	9	27	Të sigurohet trajnimi i stafit për licencimin e shërbimeve	Drejtoria përkatëse për licencimin e shërbimeve dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
		Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve		5	9	45	Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit duke themeluar grupe pune teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e OJQ-ve. Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve periodike konsultative Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të aktiviteteve të luftës kundër tij		
<b>10.</b>	<b>MENAXHIMI I PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE</b>	Mungesa e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronës së paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	5	10	50	Miratimi dhe publikimi i listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronës së paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim	Kuvendi i komunës, Kryetari i komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Dhjetor i çdo viti



		Mos mbikëqyrja e dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale					Caktimi i zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe raportimin pronave të paluajtshme komunale të dhënies në shfrytëzim	Kryetari i komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Dy herë në vit
11.	<b>PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT PËR ZYRTARËT KOMUNAL</b>	Vendimmarrje te rastet e konfliktit të interesit	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës	3	4	12	Deklarimi dhe shmangia nga vendimmarrja në rastet e konfliktit të interesit	Zyrtarët komunalë	Në vazhdimësi
		Mos deklarimi i pasurisë i zyrtarëve të lartë publikë komunal					Deklarimi i pasurisë sipas afateve ligjore	Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
12.	<b>SUBVENCIONET KOMUNALE</b>	Mungesa e Planit për ndarjen e subvencioneve	Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës				Hartimi i Planit për ndarjen e subvencioneve për vitin fiskal	Drejtoritë/Njësitë e buxhetuara me subvencione	30 ditë pas miratimit të Ligjit për Buxhet

		Ndarja e subvencioneve në kundërshtim me aktet ligjore dhe aktet e brendshme të komunës				Të bëhet ndarja e subvencioneve bazuar në planin vjetor dhe në në harmoni me Rregullën (MEF) 2017/4 dhe Rregulloret komunale në fuqi	Kryetari i komunës, Drejtoritë/Njësitë e buxhetuara me subvencione	Në vazhdimësi/ Sipas planit vjetor
--	--	---	--	--	--	--	--	---------------------------------------

DRAFT